



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot.718

Tiranë 28/8/2025

VENDIM

Nr. 29, datë 28.8.2025

**PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT MBI REALIZIMIN E BUXHETIT
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR TREMUJORIN E DYTË TË MBYLLUR MË 30 QERSHOR 2025”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, nenit 62 të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 20, pika 5 dhe pika 6 i Rregullores nr. 34, datë 27.11.2020 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 6, pika 2, shkronja “d”, të nenit 8, pika 2, shkronja “m”, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 6, pika 1, shkronja “a” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të nenit 18, pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit mbi realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për tremujorin e dytë të mbyllur më 30 qershor 2025”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar



**AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE**

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (+) 2362 989/2347 298 f: +355 (+) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al